DigitAlb
FERTA ESTIVE
E DERI NË 1,500 LekË

U ekzekutua me 9 plumba/ Biznesmeni e pa vrasësin para se ta qëllonte, e goditi me tavllën e duhanit

17:56, 17/12/2022

A- A A+

Policia ka shoqëruar në komisariat për të marrë dëshminë e personave të cilët kanë qenë dëshmitarë në skenën e krimit dhe familjarë të viktimës lidhur me ekzektimin me 9 plumba të Edmond Papës, por ende nuk ka një të dyshuar apo shpallur në kërkim. Dy janë pistat e hetimit ku është përqëndruar policia për hetimin e ngjarjes. Prishja e pazarevë të drogës pasi 49-vjeçari ka kryer disa vite burg në Greqi për trafikim droge dhe ka qenë i skeduar në Angli për të njëjtën akuzë. Pista e dytë është ajo e konflikteve për pronën, pasi Papa kishte disa biznese në jug të vendit.

Nga Syri Tv

LEXO EDHE:
Aksident në Shkodër-Koplik, Volkswagen-i përplas burrin me biçikletë

Biznesmeni Edmond Papa me origjinë nga Roskoveci dhe banes në Sarandë, i cili mbeti viktimë një ditë ma parë pasi u qëllua me 9 plumba në një lokal në kryeqytet, sapo kishte ardhur nga Britania në vendin tonë. ***Syri Tv*** na mësuar detaje të reja në lidhje me atentatin ndaj tij.

49-vjeçari kishte vetëm pak orë që kishte mbërritur në Tiranë me automjetin e tij tip Mercedes Benz G Class. Pasi la nënën në banesën e vëllait, shkoi në lokalin përballë në rrugën 'Fadil Bodinaku' në Selitë. Pak çaste më vonë atentatori i cili dyshohet se e kishte survejuar prej disa ditësh, afrohet për të qëlluar drejt objektivit.

Në momentin që ka parë atentatorin të afrohet drejt tij, Papa ka reaguar duke e qëlluar me tavllën e duhanit në tavolinë. Por kjo nuk e parandaloi dot atentatorin, i cili me një pistoletë tip Glok derdhi 9 plumba drejt objektivit.

Siç mund ta shohim kjo është fotoja, e cila është shkrepur vetëm pak minuta pasi ekzekutori qëlloi mbi 49-vjeçarin. Papa u transportua në spitalin e Traumës, por nuk arriti t'i mbijetojë plagëve që mori dhe ndërroi jetë pak minuta pas ngjarjes.

Në ambinetet e lokalit ku ndodhi dhe ngjarja ka pasur edhe disa persona të cilët menjëherë pas ngjarjes policia i ka marrë në pyetje.

Ndërkohë janë sekuestruar edhe kamerat e sigurisë në lokal, por edhe ne zonën për'rreth. Pas verifikimeve ka rezultuar se autori ka pasur një kapuç të zi, gjë e cila vështrëson edhe identifikimin e tij. Pasi ka kryer ekzekutimin ai është larguar nga vendi i ngjarjes përmes një rrugice. Dyshohet se autori është ndihmuar nga një person tjetër i cili e ka pritur në rrugën kryesore me një automjet.

49-vjeçari rezulton pronari i hotelit 'Blue Sky' në Sarandë, por ka pasur në pronësi edhe disa biznese të tjera në jug të vendit.

Edmond Papa në të shkuarën e tij ka qenë i skenduar për trafikim të lëndëve narkotike në Angli, dhe ka kryer disa vite burg në shtetin fqinj Greqi për të njëjtën akuzë, ndërkohë së fundmi ai mbant edhe mbiemrin Hoxha.

© SYRI.net

Taboola Feed

Kostoja e transplantit të flokëve në Turqi mund t'ju befasojë
Transplantet e flokeve | Iidhje te sponsorizu... | Sponsored

Shikoni sa mund t'ju kushtojnë implantet dentare të gjithë gojës ...
Implantet Dentare | Kërko reklama | Sponsored


Krimi monstruoz - 'Të djeg, siç dogja Menduhun'/ Marjeta Karaj u zbulua nga përgjimet pasi kërcënoi një tjetër borxhli
Gjykata e Tiranës ka cakturar masën e sigurisë "arrest në burg" për Gazmend Ngotën dhe Marjeta Karajn, të akuzuar për vrasjen e 61-vjeçarit Menduh Kurt-Deda në vitin ...
Syri | Lajme i fundit

Vetura të riposeduara në Tirana: çmimet mund t'ju befasojnë
Ofertat e makinave | Kërko reklama | Sponsored

Lexo edhe:

EMRI/ Sapo ishte kthyer nga Franca, kush është autori që i vuri flakën komisariatit në Elbasan

VIDEO/ Zjarr në komisariatin e Elbasanit, i riu i vë flakën dritares së ankesave të qytetarëve

Makina me shpejtësi merr para gruan në Elbasan, 50-vjeçarja në gjendje të rëndë

Komentet

Shto koment

Emri

Shkruani komentin tuaj

Posto

TË NGJASHME

Aksident në Tiranë, makina përplas 60-vjeçaren

VIDEO/ Aksident në Korçë, përplaset furgoni me 21 nxënës

Shpërthen bombola e gazit në një banesë në Maliq, 3 të plagosur nisen drejt Tiranës

29-vjeçarja hidhet nga shkëmbi në Kishën e Laçit dhe përfundon në humnerë

Atentati në Tiranë, Softa: Krimi godet kudo dhe kurdo, Policia e Shtetit mbështet kriminelët

Aksion në Kosovë, sekuestrohen mbi 10 miljë euro false, policia gjen elektroshok dhe leva hekuri

Vrasja e Brikon Sanajt, autori e bëri planin në Belgjikë, hyri ilegalisht në Shqipëri

më të lexuarat

EMRI/ Sapo ishte kthyer nga Franca, kush është autori që i vuri flakën komisariatit në Elbasan

VIDEO/ Zjarr në komisariatin e Elbasanit, i riu i vë flakën drita. së ankesave të qytetarëve

Makina me shpejtësi merr para gruan në Elbasan, 50-vjeçarja në gjendje të rëndë

Aksident në Shkodër-Koplik, Volkswagen-i përplas burrin me biçikletë

VIDEO/ Aksident në Korçë, përplaset furgoni me 21 nxënës

U ekzekutua me 9 plumba/ Biznesmeni e pa vrasësin para se ta qëllonte, e goditi me tavllën e duhanit

Shpërthen bombola e gazit në një banesë në Maliq, 3 të plagosur nisen drejt Tiranës

29-vjeçarja hidhet nga shkëmbi në Kishën e Laçit dhe përfundon në humnerë

Atentati në Tiranë, Softa: Krimi godet kudo dhe kurdo, Policia e Shtetit mbështet kriminelët

DENONCO

SYRI.net është agencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net